

# UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”



## RREGULLORE PËR UNIVERSITETIN VEROR NDËRKOMBËTAR

Gjakovë,

16.03.2020

Në bazë të nenit 43 dhe nenit 49 pika 1.3 e Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani” (Tutje referuar si UGJFA), Senati i UGJFA-së me datën \_\_\_\_\_2020 miratoi:

## **RREGULLORE PËR UNIVERSITETIN NDËRKOMBËTAR VEROR**

### **Neni 1**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

- 1.1. Më këtë Rregullore përcaktohet baza ligjore për themelimin dhe funksionimin e “Universitetit Ndërkombëtar Veror” (në versionin anglisht “International Summer University”) në UGJFA.
- 1.2. Kjo rregullore përkufizon misionin, vizionin, organizimin, fushë veprimtarinë, funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat e “Universitetit Ndërkombëtar Veror”.

### **Neni 2**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i “Universitetit Ndërkombëtar Veror” është të ofrojë një mjedis akademik të përqendruar me klasa më të vogla dhe më pak orë mësimi. Për shkak se kohëzgjatja e studimit është e kufizuar, mësimdhënësit zakonisht vendosin synime shumë precize të studimit. Studentët do të kenë mundësi marrin një argumentim të qëndrueshëm në çështjen lëndore.

### **Neni 3**

#### **Misioni**

Misioni i “Universitetit Ndërkombëtar Veror” është të promovojë vlerat akademike dhe shkencore të UGJFA-së në vend dhe në arenën ndërkombëtare, të promovojë mobilitetin e studentëve dhe personelit akademik si mundësi për transferim të dijeve dhe shkathtësive dhe shkëmbim të përvojave akademike.

### **Neni 4**

#### **Vizioni**

Vizioni i “Universitetit Ndërkombëtar Veror” është që përmes mobilitetit akademik dhe shkencor, UGJFA-ja të shndërrohet në një qendër ndërkombëtare të arsimit, shkencës dhe promovimit të vlerave kulturore të Gjakovës dhe Rajonit të Dukagjinit në përgjithësi.

## **Neni 5**

### **Struktura organizative e “Universitetit Ndërkombëtar Veror”**

Struktura organizative “Universitetit Ndërkombëtar Veror” përbëhet nga:

1. Këshilli Organizativ;
2. Kryesuesi i Këshillit Organizativ; dhe
3. Koordinator i “Universitetit Ndërkombëtar Veror”.

## **Neni 6**

### **Këshilli organizativ**

6.1 Këshilli organizativ përbëhet prej 7 anëtarëve me të drejtë vote.

6.2. Anëtarët e Këshillit organizativ zgjedhën nga Senati i UGJFA-së me propozim të Rektorit.

6.3. Struktura e Këshillit organizativ përbëhet nga:

- a.) 3 anëtar nga radhët e personelit akademik të UGJFA-së;
- b.) 1 anëtar nga radhët e personelit administrativ të UGJFA-së;
- c.) 2 anëtar nga universitetet partnere;
- ç) 1 anëtar nga Parlamenti Studentor i UGJFA-së.

6.4. Këshilli organizativ është përgjegjës është përgjegjës për organizimin e aktiviteteve brenda “Universitetit Ndërkombëtar Veror”.

6.5. Këshilli organizativ e përgatit udhëzuesin për studentë si dhe dokumentet tjera relevante për “Universitetin Ndërkombëtar Veror”.

6.6. Mandati i Këshillit Organizativ është një (1) vjeçar.

## **Neni 7**

### **Koordinatori i “Universitetit Ndërkombëtar Veror”**

7.1. Koordinator i “Universitetit Ndërkombëtar Veror” zgjidhet nga Senati i UGJFA-së me propozim të Rektorit.

7.2. Koordinator duhet të zgjidhet nga radhët e personelit akademik të UGJFA-së. Koordinator duhet të jetë person me kredenciale ndërkombëtare akademike – shkencore, dhe që përveç gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, mund të komunikojë edhe në gjuhën angleze.

7.3. Koordinatorin është përgjegjësi kryesor administrativ për mbarëvajtjen e punës së “Universitetit Ndërkombëtar Veror”. Për punën e tij i përgjigjet Këshillit Organizativ dhe Senatit të UGJFA-së.

7.4. Mandati i Koordinatorit është një (1) vjeçar me mundësi vazhdimi.

## **Neni 8**

### **Organizimi i punës dhe modulet e “Universitetit Ndërkombëtar Veror”**

1. Universitetit Ndërkombëtar Veror ofron shkollim në formë modulare apo ligjëratave me karakter intensiv në kohëzgjatje deri në dy (2) javë. Modulet propozohen organizohen nga njësitë akademike të UGJFA-së, si në vijim:
  - a.) Fakulteti i Filologjisë;
  - b.) Fakulteti i Edukimit;
  - c.) Fakulteti i Mjekësisë;
  - d.) Fakulteti i Shkencave Sociale; dhe
  - e.) Fakulteti i Shkencave Aplikative.
2. Modulet e propozuara nga njësitë akademike aprovohen nga Senati i UGJFA-së në bashkëpunim me institucionet partnere dhe palët tjera të interesit.
3. Ligjëratat në module do të mbahen nga personeli akademik i UGJFA-së dhe personeli i institucioneve partnere.
4. Modulet e “Universitetit Ndërkombëtar Veror” duhet të përgatiten paraprakisht dhe të njoftohen palët e interesuara.

## **Neni 9**

### **Përzgjedhja e personelit akademik ligjërues**

1. UGJFA obligohet të shpall konkurs të brendshëm për pranim të personelit akademik për ligjërime në “Universitetit Ndërkombëtar Veror”. Në konkurs përcaktohen edhe kushtet për aplikim.
2. Për programet ndërkombëtare personeli akademik duhet të ketë njohuri të lartë të gjuhës angleze.
3. Procedura e rekrutimit dhe intervistimi i kandidatëve të paraqitur në konkurs zhvillohet nga Këshilli Organizativ.
4. Këshilli organizativ i “Universitetit Ndërkombëtar Veror” i propozon Senatit të UGJFA-së listën me kandidatët e përshtatshëm për ligjërime.
5. Personeli akademik për punën në Universitetit Ndërkombëtar Veror do të kompensohet me pagë shtesë.
6. Shuma e pagesës do të përcaktohet çdo vit me vendim nga Këshilli Drejtues i UGJFA-së.

## **Neni 10**

### **Procedura e aplikimi të studentëve**

1. Të gjithë studentët të cilët gëzojnë statusin e studentit në një institucion të Arsimit të Lartë kanë të drejtë të aplikojnë për të qenë pjesëmarrës në “Universitetin Ndërkombëtar Veror”
2. Studentët duhet të aplikojnë për modulën përkatës dhe të plotësojnë formularin standard të cilin e gjejnë në web faqen e UGJFA-së.
3. Në aplikim studenti duhet të dërgojë CV-në dhe dokumentet përcjellëse.
4. Vlerësimi i kandidatëve të cilët kanë aplikuar bëhet nga Këshilli Organizativ.
5. Këshilli organizativ bën vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatëve të cilët kanë aplikuar dhe përgatishin listën finale.
6. Në “Universitetin Ndërkombëtar Veror” mund të aplikojnë studentët të cilët kanë fituar të paktën 30 ECTS kredi në studimet e rregullta.

## **Neni 11**

### **Të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve pjesëmarrës**

1. Me përfundimin e suksesshëm të “Universitetit Ndërkombëtar Veror”, studentët pajisen me certifikatën e pjesëmarrjes.
2. Studentëve duhet t’u lëshohet edhe një shtojcë e certifikatës e cila tregon përmbajtjen e modulit të përfunduar dhe numrin e ECTS kredive të fituara.
3. Studentët mund të shfrytëzojnë të gjitha burimet e UGJFA-së, si: bibliotekën, sallën e IT-së dhe resurset tjera në dispozicion të studentëve.
4. Studentët janë të obliguar të respektojnë rendin shtëpiak dhe Kodin Etik të studentëve gjatë prezencës në “Universitetin Ndërkombëtar Veror”.
5. Këshilli Organizativ me propozim të Koordinatorit ka të drejtë të përjashtojë nga “Universiteti Ndërkombëtar Veror” pjesëmarrësit nëse shkelin rregullat e UGJFA-së.

## **Neni 12**

### **Aktivitetet tjera**

1. Gjatë organizimit të Universitetit Ndërkombëtar Veror do të organizohen aktivitete tjera.
2. Si aktivitete tjera mund të jenë:
  - a.) Organizimi i tryezave të rrumbullakëta;
  - b.) Promovimi i librave të ndryshme;
  - c.) Seminare profesionale;
  - d.) Ligjërata të hapura me personalitete të njohura nga jeta publike;
  - e.) Aktivitete artistike;

f.) Vizita nëpër vendete veçanta turistike dhe historike.

### **Neni 13**

#### **Tarifat e pjesëmarrjes dhe financimi i “Universitetit Ndërkombëtar Veror”**

1. Tarifat e pjesëmarrjes caktohen çdo vit me vendim nga Këshilli Drejtues i UGJFA-së.
2. Pjesëmarrësit e “Universitetit Ndërkombëtar Veror” marrin përsipër t’i mbulojnë të gjitha shpenzimet në lidhje me akomodimin, ushqimit, udhëtimit, sigurimet shëndetësore, etj.
3. Buxheti përcaktohet çdo vit me vendim të Këshillit Drejtues të UGJFA-së.
4. Universitetit Ndërkombëtar Veror ka të drejtë të pranojë donacione të ndryshme nga burimet publike dhe private. Donacionet e tilla duhet të bëhen transparentet dhe të shfrytëzohen për nevojat e Universitetit Ndërkombëtar Veror.

### **Neni 14**

#### **Periudha e Organizimit të Universitetit Ndërkombëtar Veror**

1. Universitetit Ndërkombëtar Veror organizohet në muajin korrik apo gusht të secilit vit kalendarik.
2. Kalendar i organizimit të Universitetit Ndërkombëtar Veror përcaktohet çdo vit nga Senati i UGJFA-së, në bashkëpunim me universitetet partnere ndërkombëtare dhe palët tjera të interesit.

### **Neni 15**

#### **Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

1. UGJFA mund të organizojë edhe “Universitet Dimëror”. Organizimi i punës në Universitetin Dimëror zhvillohet në përputhje me këtë rregullore.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori i UGJFA-së.
3. Ndryshimi i kësaj rregulloreje bëhet sipas procedurës së miratimit.

Gjakovë,

\_\_\_\_\_. 2020

**Kryesuesi i Senatit**

**Prof. Ass. Dr. Artan NIMANI**

---